



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.410/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli -anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhje Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë:

#### **VE N D I M**

Refuzohet e pabazuar ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.410/2025 e datës 06.02.2025, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025.

#### **A r s y e t i m**

Me datën 06.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 5 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Istog, është njoftuar se në SHFMU "Bajram Curri" në Istog, mësimi do të përfundojë më herët se që është paraparë me orarin mësimor, me arsyetimin se shkolla do të dezinfektohet. Prindërit e nxënësve janë njoftuar përmes Viber, që mësimi do të përfundojë në orën 16:00, pa ndonjë arsye tjetër, po që ky është vendim i drejtorisë së shkollës.

Më tej në ankesë theksohet se pas një hulumtimi të aktivistëve të LVV-së, në Istog, është vërtetuar që njoftimi për përfundimin e mësimin në orën 16:00, është bërë në të gjitha shkollat e Komunës së Istogut, dhe ky njoftim është shpërndarë tek drejtorët e shkollave nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog.

Meqenëse në shkolla nuk është bërë dezinfektim profesional (sepse asnjë kompani e dezinfektimit nuk është angazhuar dhe për dezinfektime nuk mund të vendoset brenda ditës) e vetmja arsye për përfundimin e hershëm të mësimit në këtë komunë janë tubimet elektorale që kishte planifikuar ti mbajë në këtë komunë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës.

Më datë 5 shkurt 2025, sipas pretendimeve ankimire, Subjekti Politik LDK, kishte paraparë që nga ora 16:45 të mbajë tubim elektorale-forumi i gruas, në Hotel Trofta, Istog ( ku i pranishëm do të jetë edhe kandidati për deputet Ilir Ferati). Në këtë tubim shihet pjesëmarrja e Drejtorit të SHFMU Bajram Curri" dhe i shumë mësimeve.

Ndërsa, nga ora 18:00 ishte planifikuar të mbahet tubimi elektorale në palestrën sportive "IBOS", Istog (prezent do të jetë edhe kandidati për Kryeministër Lumir Abdixhiku). Si provë ka bashkangjitur fotografitë nga tubimi dhe njoftimi.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LDK, pretendon se me rastin e Njoftimit zyrtar të bërë nga Drejtoria Komunale e Arsimit për dezinfektim të ambienteve të brendshme të shkollave, është bere shkelja e nenit 36 paragrafi 2 te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 5 paragrafi 2, nën paragrafi 5 te Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, nuk qëndron.

Më tej në përgjigje theksohet se Drejtori i Drejtoratit të Arsimit në Komunën e Istog, në rrjetin e komunikimit Viber, ka njoftuar tek të gjithë drejtoret e institucioneve arsimore që për shkak te dezinfektimit te ambienteve të brendshme të shkollave, ruajtjes se shëndetit të nxënësve e mësimeve si dhe personelit teknik, procesi mësime të përfundoj në ora 16:00, dhe se ky procesi i dezinfektimit nuk ndërlidhet me asnjë proces tjetër politik.

Në këtë rast SHFMU "Bajram Curri" në Istog, ka respektuar njoftimin duke nxjerr Vendim ku njofton personelin se procesi mësime do te përfundoj në ora 16:00. Gjithashtu ekzistojnë edhe njoftime tjera nga shkolla të tjera për këtë proces me rendësi shëndetësore për nxënësit, personelin arsimor dhe teknik.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

**Ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se Subjekti Politik e LDK, ka bërë njoftime përmes Drejtoratit të Arsimit në Komunën e Istogut, që mësime të përfundojë më herët se që është paraparë me orarin mësime, me arsyetimin se shkolla do të dezinfektohet, me qëllim që mësimeve të marrin pjesë në tubim elektorale të LDK-së, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitave ligjore të LKP-së.


Nga provat materiale të bashkangjitura në ankesë nga Subjekti Politik LDK, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e Subjektit Politik LDK, nuk është shkelur dispozita ligjore e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LKP, konkretisht neni 36 paragrafi 1, 2,

dhe 3, i cili percakton: : “1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje 2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunës i publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik 3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik”. Paneli në kontekst të gjendjes faktike të përshkruar anekse dhe provave të bashkangjitura konsideron se zyrtaret publik në rastin konkret nuk janë përfshirë në shkelje të dispozitave të lartecaktuara, pasi që, zyrtaret publik në fushat zgjedhore kanë marr pjesë pas përfundimit të orarit të punës (pas orës 16:00), dhe nuk është në kompetencë të zyrtareve publik, të kujdesen për vendimmarrjen nga varësit e tyre, mirëpo ata kanë respektuar vendimet e drejtoreve të shkollës dhe kanë lëshuar fëmijët në orën 16:00, ashtu, siç janë njoftuar me vendim nga Drejtoret e shkollës dhe Drejtori i Drejtoratit të Arsimit në Komunën e Istog.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor në hapësira të palejuara konkretisht në ndërtesa, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.410/2025 më datën 09.02.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.